

AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË "NDËRTUESI" SHPK

Sot më datë Unë i quajhuri Abdyl Nazif Deromemaj i lindur më 4-10-1 3 në Mesaplik-Vlorë dhe banues në Vlorë në lagje "Kushtrimi" rrë Rakip Malile Nr 132 , themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar si ortak i vetëm, "NDËRTUESI" "SHPK"

NENI 1

Shoqëria emërohet "NDËRTUESI" "SHPK" Projektim - ndërtim

NENI 2

Selia e shoqëris do të jetë në Vlorë me të drejtë për ta ushtruar aktivitetin e saj teritorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj

NENI 3

Shoqëria ka një aktivitet të saj projektim - ndërtim 12 vjet dhe mund të shpërbëhet në çdo kohë

NENI 4

Shoqëria ka aktivitet të saj:

Studimin, projektimin dhe ndërtimin e veprave civile, industruale, turistike, bujqësore e tj, dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to, punime restaurimi, punime dheu, betoni e beton/armeje të zakonshme, punime shëmbjesh, punime ujësjellësash, kanalizime, impijante vaditëse, vepra arti rrugore e hekurudhore, punime të mbrojtjes të sistemeve hidraulike, kullimi, ujitja e tokave, diga galeri tunele punime karpenjerije, metalike si dhe prodhimi i materjaleve të ndërtimit e tregtimi i tyre e tjera në fushën e ndërtimit

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100000 lekë

ORTAKU I VETËM

ABDYL NAZIF DEROMEMAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
N O T E R I A

Nr 3910 rep
Nr _____ kol

V S H E R T E T I M

Sot më datë 28/05/85 para meje Noteres Jetmira Veraj u paraqit personalisht Abdyl Deromemaj, madhor, me zotësi të plotë juridike, i njohur personalisht prej meje në bazë të letërnjoftimit që më paraqiti i cili më deklaroi se sa më sipër është shkruajtur me vullnetin e tij të lirë Nënshkrimi i tij u vërtetua edhe nga unë Noterja

N O T E R E
dot JETMIRA VERAJ



S T A T U T

I SHOQERISE " NDERTUESI " SH.P.K

(ORTAK I VETEM)

NENI I

Formohet shoqeria tregtare me emertim " NDERTUESI " SH.P.K ? me pergjegjesi te kufizuar e themeluar nga ortaku i vetem Z. Abdyl Detomema , lindur me 1939 ne Mesaplik dhe banues ne Vlore

SELIA E SHOQERISE

NENI II

Selia e shoqerise do te jete ne Vlore , me te drejte per te ushtruar aktivitetin e saj ne te gjithë territorin e Republikës se Shqiprise dhe jashte saj

KOHEZGJATJA

NENI III

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike e shoqerise eshte 12 vjet dhe mund te shperbehet ne çdo kohe .

OBJEKTI I VEPRINTARISE

NENI 4

Veprimtaria e shoqerise eshte ne fushen e studimit , projektimit dhe zbatimit te ndertimeve dhe te prodhimit e tregtimit te materialeve te ndertimit .

-Objekt i veprimtarise se shoqerise do te jene :

-Punime dheu , murature , beton e beton arme , punime shembjesh .

- Ndertime civile , industriale , turistike , bujqesore etj , e kompletim me instalimet e nevojshme per to .

- Punime Restaurimi

- Punime , Ujsjellsa , Kanalizime , impiante vaditese

- Vepra arti rrugore e hekurudhore

- Punime hidraulike , Diga konstruksion druri e metali .

- Punime te ndryshme ndertimi te kategorive te tjera .

NENI 5

Shoqeria mund te ndryshoje emrin , seline si dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve qe do te marre pronari i saj .



KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali themelues i shoqerise eshte 100.000 (njeqindmije) leke te derdhura ne Banken Tregtare Vlore .

Kapitali i shoqerise do te shtohet sipas vendimeve qe do te marre ortakut i vetem .

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

NENI 7

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky staturo dhe ato te legjislacionit shqiptar ne fuqi .
Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me rregjistrimin e saj si person juridik ne Gjykatën e Tiranës , ndersa ushtron aktivitetin me rregjistrimin ne zyren e tatimeve .

NENI 8

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje "NDERTUESI DEROMEMA "

NENI 9

Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitimin duke u mbeshtetur ne parimet e likjditetit , sigurise e rentabilitetit .
Ajo pergjigjet vet per detyrimet e saj kontraktore e jashtekontraktore, brenda kapitalit te saj

NENI 10

Shoqeria eshte prone e themelusit te saj .
Ajo mer vendime ne zbatim te ligjeve ne fuqi dhe sipas ketij statuti , te cilat jane te detyrueshme per zbatimin per te gjithë punonjesit ne kete shoqeri .

NENI 11

Ortakut i vetem sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e veprimtarise shoqerise emron administrator te pergjithshem dhe puneson punonjes te veprimtarive te ndryshme ekonomike te permendura ne nenin 4 te ketij statuti .



NENI I2

Ortakut i vetem i shoqerise dhe administratori i ngarkuar prej tij jane te veshurme te gjitha fuqite per drejtimin e zakonshem e te jashtezakonshem te shoqerise pa asnje lloj kufizimi .
Ata kane mundesi te kryejne te gjitha aktet qe i konsiderojne te nevojshme per arritjen e qellimeve te shoqerise . Ata kane te drejte te blejne e te kembejne pasuri , te lidhen me shoqeri te tjera te vendit e te huaja , te kryejne veprimtarite ndryshme prane zyrave private e shteterore , qe kane te bejne me garanci , hipotekat etj. Te kryejne prane instituteve bankare ,veprime financiare e depozitimi , kreditimi , pagesa dhe arketime .
Administratori ne qdo rast eshte i detyruar te njoftoje dhe ti jap llogari ortakut te vetem brenda 4 oreve nga koha e kryerjes se veprimeve .

NENI I3

Perfaqesimi i shoqerise i perket ortakut te vetem dhe administratorit te ngarkuar prej tij .
Ata kane te drejten e perfaqesimit te shoqerise ne organet gjyqesore dhe administrative , te caktoj dhe te pushoj avokat per qdo problem .

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI I4

Veprimet ekonomike e financiare te shoqerise mbyllen ne 31 Dhjetor te qdo viti .
Ne fund te qdo periudhe ushtrimore , administratori nxjerr bilancin kontabel te shoqerise me llogari fitim , humbje , mbeshtetur ne ligje dhe ne rregulla te mbajtjes se kontabilitetit nga subjektet private , percaktuar nga organet kompetente te sistemit fiskal .
Bilanci kontabel miratohet nga ortakut i vetem , i cili vendos per krijimin e fondeve te ndryshme , per shvillimin e garancine e shoqerise , fondin e akumulimit , fondin rezerve etj .

N E N I I5

Te ardhurat neto pas vecimit te fondeve ligjore te permendura me siper dhe shlyerjen e detyrimeve fiskale nga fitimi , i mbesin per perdorim ortakut te vetem .



SHPERNDARJA E SHOQERISE

NENI I6

Shperberja e shoqerise mund te vije ne qdo kohe dhe per cfardo shkaku si humbja e kapitalit , pamundesi veprimtarie etj .
Ne keto raste ortakut i vetem vendos mbi menyren e likujdimit dhe cakton nje ose me shume likjdator . Keta bejne kujdes qe shoqeria te likujdoje me para qe ju ka personave te trete fizik dhe juridik .

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI I7

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotesimeve nga ortakut i vetem si dhe ligjeve perkatese shqiptare .

NENI I8

Ky statut perpilohet ne disa kopje per t'ju shperndar organeve kopetente , ndersa nje kopje mbetet si pjese perberese e dokumentacioni te themelimit te shoqerise .

THEMELESI - ORTAKU I VETEM

Abdyl Deromema

Republika e Shqiprise
Ministria e Drejtesise
Noteria Vlore
Nr. 3011... rep .

V E R T E T I M

Sot , me daten 28/05/95 1995 , para meje noteres Jetmira Veraj , u paraqit Abdyl Deromema , lindur ne Mesaplik e banues ne Vlore L. " Kushtrimi " Rr. R. Malile Nr. 1329 , madhor , me zotesi te plote juridike per te vepruar , i panjohur prej meje por per indetitetin e te cilit u sigurova sipas ligjit me leternjoftimin e tij personal , i cili me deklaroi se statuti i siper hartuar jashte kesaj zyre eshte ne perputhje te plote me vullnetin e tij dhe e nenshkruan ate para meje . Sipas ligjit dhe une noterja e vertetoj ate rregullisht .



NOTERE
Jetmira Veraj